

KONTRATË THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Mërkuri International” Sh.P.K.

Sot me datë 09.12.2021, në Sarandë, me vullnetin tim të lirë, unë i nënshkruari:

- Eltjon Mërkuri, i biri i Vasil, i datëlindjes 24 Maj 1988, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit No.035121105 dhe numër personal I80524113E me datë lëshimi 15/11/2019

ne zbatim te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” ,

Neni 1

Vendosa te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“Mërkuri International” shpk.**

Neni 2

Ortakt themelues të shoqërisë janë: z. Eltjon Mërkuri.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

- Transport kombetar dhe nderkombetar te pasagjereve, turisteve dhe bagazheve
- Transport mallrash
- Agjensi e sherbimit turistik
- Organizimi i guidave turistike brenda dhe jashte vendit
- Promovim i turizmit brenda dhe jashte vendit
- Sherbim transporti per te trete
- Sherbim akomodimi, bar-restorant

Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimatri tjetër tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

Neni 4

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortakë, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 10,000 lekë (dhjetëmijë) dhe përbëhet nga 1 (nje) kuote, e ndarë si më poshtë:

1. Eltjon Mërkuri, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 10,000 (dhjetemije) lekë, ose 100% të kapitalit themeltar

Neni 6

Selia e shoqërisë është Lagja 3, Rruga "Musa Demi" Nr.21, Sarandë.

Neni 7

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar në kohë dhe fillon që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 8

Administrator i shoqërisë do të jetë z. Eltjon Mërkuri, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë për 5 vite, me të drejtë rizgjedhje dhe është i ngarkuar të kryejë akte dhe të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 9

Personaliteti juridik i shoqërisë fitohet me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Aktiviteti i saj do të fillojë pas kryerjes së procedurave ligjore. Në aktivitetin e shoqërisë do të përmbahemi statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj legjislacionin në fuqi. Kjo kontratë themelimi u redaktua në katër kopje, me vlerë të njejtë ligjore, një kopje dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, një kopje dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe nga një kopje ortakëve themelues të shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË "Mërkuri International" SH.P.K.

Eltjon Mërkuri _____

